

Franciska Zhitia Ymeri

Saranda Bogaj Sheremeti

TORTURA

1. Nocioni i torturës

Tortura është një akt ç'njerëzor, poshtërues e degradues, e ndërmarr nga personi zyrtar, një veprim i kryer me dashje, me qëllim që nga ai person të merren informata, ose pohime të ndryshme për veprime të cilat i ka kryer apo dyshohet se i ka kryer.

Tortura si një trajtim mizorë, rrënjët e veta i ka që nga historia e hershme, por që po praktikohet nga shumë shtete edhe në ditët e sotme.

Që të mund të kuptojmë më mirë trajtimin e temës që kemi zgjedhur, fillimisht duhet të kuptojmë dhe shtjellojmë atë se çka kuptojmë me torturë.

Torturë do të thotë "dhunë e rëndë trupore apo mundim me mjete e mënyra të ndryshme, që i bëhet dikujt për ta detyruar të flasë, të tregojë të fshehtat, të nënshtrohet, të zbulojë fajin dhe bashkëfajtorët etj.; rrahjet, lënia pa ngrënë, pa ujë e pa gjumë, ngacmimi i plagëve etj.

Ndërsa, sipas normës juridike ndërkombëtare, nocioni i torturës është përkufizuar në kuptim edhe më të gjerë: "torturë do të thotë çdo veprim që i bëhet një personi, me qëllim që t'i shkaktohen dhimbje ose vuajtje të rënda fizike ose mendore për ta detyruar atë ose ndonjë person të tretë që të japë informacione ose pohime për ta dënuar veprën, të cilën ai ose ndonjë person i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose me qëllim që të frikësohet ose detyrohet ai ose ndonjë person i tretë, ose për ndonjë arsye tjetër, të

bazuar në diskriminimin e cilitdo lloji, kur dhimbjet ose vuajtjet e tilla shkaktohen nga një person zyrtar ose nga një person i tretë sipas detyrës zyrtare ose me nxitjen a pëlqimin e tij. Ky nocion nuk përfshin vuajtjet dhe dhimbjet që rezultojnë vetëm nga sanksionet ligjore, që u përkasin ose janë shkaktuar prej tyre.”

Tortura është përdorur qysh në fillimet e shoqërisënjerëzore. Në Evropë, ajo arriti kulmin, në periudhën e inkuizicionit. Tortura u përdor si mjet kryesor terrori në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera komuniste të Evropës Lindore. Sipas konventës së OKB-së, datë 26 Qershor 1987, tortura përcaktohet: "Torturë quhet çdo veprim, me anën e të cilit një personi i janë shkaktuar me dashje dhimbje ose vuajtje të rënda fizike ose mendore, me synimin për të marr informata ose pohime, për ta ndëshkuar për një veprim që ai ka kryer ose dyshohet e ka kryer, për të frikësuar ose për të bere presion, ose për çdo motiv tjetër"

Karakteristikat që i përmban kjo vepër penale janë:

1. Lidhur me përgjegjësinë penale, kjo vepër penale mund të kryhet **vetëm me dashje**,
2. Këtë vepër penale mund ta kryej **vetëm personi zyrtarë** dhe atë vetëm nëse veprën e kryen gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.
3. Për tu konsideruar se është kryer kjo vepër penale kërkohet edhe **qëllimi i caktuar** ku personi zyrtar e përdor forcën me qëllim të nxjerrjes së deklaratës nga i dyshuari.

2. RREGULLIMI NË ASPEKTIN NDËRKOMBËTAR, KOMBËTAR

Shumë kush mund të bëjë pyetjen se: Ç’lidhje kanë të drejtat e njeriut me zhvillimin e një vendi apo me çështje të tjera që lidhen me të?. Cili është roli dhe funksioni që ato luajnë në ndërtimin dhe prospëritetin ekonomik, social dhe moral të një vendi? Përgjigjen më të mirë të kësaj pyetjeje ja dhanë burrat e Shtetit të Evropës pas shkatërrimeve të Luftës së Dytë Botërore. Ata vendosën të ndërtojnë një Evropë të mbështetur në themele më të gjëra sesa vetëm në zhvillimin ekonomik, tregjet e lira. U mendua se ishte e nevojshme të rindërtohej kontinenti mbi bazën e respektit për vlera

të veçanta, të drejtat dhe liritë të cilat përcaktojnë konceptin e shtetit të së drejtës dhe që përbëjnë shtyllën kryesore të shoqërive demokratike. Ata pra vendosën që një shoqëri nuk mund të ndërtohet pa e vendosur individin, respektin për dinjitetin e tij dhe të drejtat të cilat rrjedhin prej tij në qendër të vëmendjes.

Këshilli i Evropës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut lindën nga kjo nevojë dhe nga këto bindje.

Së bashku me Magna Kartën dhe Deklaratën Franceze të të Drejtave të Njeriut, Billi i të Drejtave i Shteteve të Bashkuara shërbeu si një model për Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila thekson se:"…është e nevojshme që të drejtat elementare të njeriut të mbrohen me dispozitat juridike të shtetit, kështu që njeriu të mos jetë i shtrënguar që në pikën e fundit t'i përvishet kryengritjes kundër tiranisë dhe shtypjes". Gjithashtu, ndër parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, është edhe Neni 5 i kësaj Deklarate, ku thuhet: "Kurrkush nuk guxon t'i nënshtrohet dhunës ose aktit të dënimit brutal, johuman ose poshtërues"; Gjithashtu, edhe sipas nenit 7 të Paktit ndërkombëtar për të drejtat qytetare e politike, parashikohet ndalimi i formave dhe të mjeteve të tjera të torturës;"Çdo njeri ka të drejtë në respektimin dhe në mbrojtjen e integritetit të tij fizik dhe mendor. Askush nuk guxon t'iu nënshtrohet vuajtjeve dhe dënimit johuman dhe poshtërues", sepse këto forma të ushtrimit të torturës janë të ndaluara, edhe me Kartën mbi të drejtat themelore në BE (Kreu I, nenet 3 dhe 4), të miratuar në Nicë, më 17.12.2000).

Gjithashtu, sipas dispozitave të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, neni 3, thuhet se "Askush nuk guxon t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve e trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese" (Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Romë, 4.11.1950hyrë në fuqi, më 3.09.1953; Konventa Evropiane për parandalimin e torturës, të dënimeve dhe të trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese, Strasburg, 26.11.1987 hyrë në fuqi më 1 shkurt 1989, paragrafët 3 dhe 4.

2.1 Tortura sipas Kodi Penal të Kosovës

Ky kod torturën si vepër penale e ka futur tek Veprat Penale kundër Lirive dhe të Drejtave të Njeriut-neni 165.

Sipas KPK: personi zyrtar ose personi i cili vepron me qellim të shtytjes ose me pëlqim apo pranim të personit zyrtar, i cili kryen aktin e torturës, dënohet me burgim prej 5-15 vjet.

Ky kod është aprovuar ne vitin 2003, ndërsa ka hyrë në fuqi tek në vitin 2004, deri në këtë vit ka ekzistuar Ligji Penal i Serbisë, i cili po të krahasohej me Kodin e tashëm Penal të Kosovës ka një dallim të madh sidomos në shqiptimin e dënimit.

Ish Jugosllavia njihet si një ndër vendet që më së paku i ka zbatuar ligjet në fuqi, ligjet të cilat i kanë nxjerr organet e saj, por edhe për zbatimin e marrëveshjeve, konventave, të cilat i kanë nënshkruar dhe janë shtete palë të tyre.

Ne ende jemi duke i vuajtur pasojat e asaj gjendje anarkie, në burgjet e Kosovës edhe sot e kësaj dite nuk po praktikohen sa duhet të drejtat e të burgosurve, ku shumë shpesh po hasemi në protesta të ndryshme nga ana e të burgosurve.

Sipas Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës në vitin 2006 janë regjistruar 500 viktima të torturës.

3. KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Askush nuk vihet nën torturë, trajtim ose ndëshkim ç'njerëzor ose poshtërues.

Të drejtat e mbrojtura nga neni 3 I Konventës lidhen drejtpërdrejt me integritetin personal dhe dinjitetin njerëzor të individit.Kështu, liria nga tortura, ndëshkimi dhe trajtimi ç'njerëzor ose poshtërues janë të drejta me rëndësi të jashtëzakonshme. Në të njëjtën kohë rregullat që lejojnë të përcaktohet nëse një shtet ka shkelur ndonjë nga këto të drejta janë, në një masë të madhe, subjektive. Këto dy elemente kanë bërë që Komisioni dhe Gjykata të interpretojnë dispozitat e Nenit 3 në mënyrë strikte, në shumicën e rrethanave.

Kështu që, Gjykata dhe Komisioni idallojnë të tre nocionet e Nenit 3 në përputhje me shkallën e ashpërsisë së trajtimit ose ndëshkimit të veçantë. Për secilin nocion ata kanë përcaktuar standardet e shkallëve të sjelljes së ndaluar si vijon:

- Tortura-trajtim ç'njerëzor që bëhet me dashje e që shkakton vuajtje shumë të rënda e mizore.
- Trajtim ose ndëshkim ç'njerëzor- të shkaktuarit e një vuajtje intensive fizike dhe mendore.
- Trajtim poshtërues-keqtrajtim që synon të krijoj tek viktimat ndjenja frike ankthi e inferioriteti të afta për ta poshtëruar e përulur ato dhe që mundësisht të thyejnëqëndresën e tyre fizike e morale.

Ja vlen të shënohet lidhur me këtë se ndonëse janë bërë shumë ankime për shkelje të nenit 3 nga të burgosur individual, Komisioni dhe Gjykata rrallë kanë gjetur shkelje në këto çështje. Gjykata gjeti shkelje të nenit 3 aty ku individët paraqitën dokumentacionin me kohë për dëmtimet që ata pretendonin se kishin pësuar ndërkohë që ishin në mbajtje nga policia dhe ku qeveria nuk ofroi shpjegime alternative të besueshme lidhur me shkakun e atyre dëmtimeve.

Gjykata ka gjetur një shkelje të Nenit 3 në çështjen Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar (1989), në të cilën një i ri gjerman, ekstradimi i të cilit kërkohej nga SHBA për vrasje e cila ndëshkohej me vdekje, do të përballej me mundësin e një burgimi të gjatë në "radhën e vdekjes". Megjithëse e pranoi se dënimi me vdekje ishe i ligjshëm në SHBA, Gjykata deklaroi se t'ia nënshtroje aplikuesin fenomenit të radhës së vdekjes ishte në kundërshtim me të drejtat që i garanton neni 3 dhe se Mbretëria e Bashkuar do të ishte përgjegjëse për këtë sipas Konventës.

Në një rast tjetër Gjykata konstatoi një shkelje aty ku mungesa e mbështetjes financiare ose emocionale dhe cilësia e ulët e kujdesit shëndetësor në vendin e kthimit ishin të papërshtatshme për të plotësuar nevojat e një individi në fazat e fundit të AIDS-it (D kundër Mbretërisë së Bashkuar (1997).

4. GJYKATA E STRASBURGUT

Asnjë organ, as institucion shtetëror nuk ka të drejtë të ushtrojë përndjekje, arrestime, përsekutime, burgosje, torturë dhe terror ndaj asnjë personi që kërkon realizimin e të drejtave dhe lirive të tij, sepse këto akte të shëmtuara antihumane dhe antinjerëzore të botës së qytetëruar janë të ndaluara dhe të dënueshme sipas normave dhe rregullave të së drejtës ndërkombëtare dhe të rendit juridik pozitiv ndërkombëtar përbëjnë krim, përkatësisht vepër penale, e cila sanksionohet rreptësisht sipas Gjykatës Ndërkombëtare të OKB-së dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ngritja e Gjykatës me një juridiksion unik në botë dëshmon dëshirën për të siguruar që kjo Konventë duhet të jetë më tepër sesa vetëm një deklaratë tjetër.

Që nga krijimi, veprimtaria e Këshillit të Evropës është përqendruar për të mbështetur respektin më të madh për këto vlera në ligj dhe në praktikë në shtetet e tij anëtare. Në këtë kontekst Gjykata luan një rol thelbësor për transformimin e të drejtave në realitet për qindra dhe mijëra persona të cilët e kanë gjetur zgjidhjen e të drejtës së tyre në Strasburg, ndërsa vendimet e saj kanë rezultuar në ndryshime të pallogaritshme në ligjin dhe praktikën e shteteve anëtare në përfitim të të gjithëve.

Përgjegjësia kryesore për zbatimin e KEDNJ sigurisht qëndron në autoritetet kombëtare. Gjykata e Strasburgut është një opsion i fundit dhe siguron zgjidhjen vetëm për një numër të vogël individësh. Me qëllim që gjykatësit dhe prokurorët të jenë në gjendje të përmbushin këtë rol të rëndësishëm ata duhet të trajnohen siç duhet. Këshilli i Evropës mirëpret përpjekjet e autoriteteve shqiptare mbi të gjitha në fushën e trajnimit në shkollën e Magjistraturës. Sa më shumë çështje të zgjidhen në gjykatat kombëtare, aq me pak njerëz do të detyrohen të sjellin aplikimet e tyre në Strasburg.

4.1 Si t'i drejtoheni Gjykatës së Strasburgut

Nëse mendoni se arsyet e ankimit tuaj kanë të bëjnë me shkeljen e një prej të drejtave të garantuara nga Konventa, ose nga njëri prej Protokolleve,

dërgoni më parë te sekretari i Gjykatës së Strasburgut një letër që përmban të dhënat e radhitura me poshtë. Kjo letër duhet t'i adresohet: Le Greffier de la Cour européenne des Droits de l'Homme Conseil de l'Europe F-67075 STRASBOURG CEDEX FRANCE. Letra juaj mund të shkruhet në gjuhen shqipe ose ndonjë gjuhë tjetër të huaj dhe duhet të përmbajë: Një përmbledhje të shkurtër të arsyeve të ankimit tuaj, si dhe citimin e së drejtës ose të të drejtave të garantuara nga Konventa dhe që i vlerësoni se janë shkelur. Këtë do ta bëni pasi të keni lexuar KonventënEvropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të gjeni nenin përkatës, p.sh. ndalimi i torturës (neni 3), e drejta për një proces të rregullt (neni 6), ndalimi i diskriminimit për shkak të origjinës kombëtare, fesë (neni 14) etj. Ankesat që keni bërë p.sh. në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë.

Listën e vendimeve të dhëna për çështjen tuaj nga një autoritet publik, duke saktësuar për çdo vendim: datën, përmbajtjen e tij të përmbledhur dhe organin që e ka dhenë. Bashkëngjitiniletrës tuaj një kopje të këtyre vendimeve. (Këto dokumente nuk do t'ju kthehen. Si rrjedhim, është në interesin tuaj të dërgoni vetëm kopje dhe jo origjinale). Ankesa mund të bëhet nga ju personalisht ose avokati i autorizuar prej jush, ose çdo person tjetër i autorizuar me shkrim prej jush. Sekretari i Gjykatës do t'ju përgjigjet. Do t'ju kërkohen ndoshta dokumente, të dhëna ose shpjegime plotësuese lidhur me ankimin tuaj. Mund t'ju informojnë mbi mënyrën se si është interpretuar Konventa në raste të ngjashme. Në rastin kur pranimi i ankesave tuaja ka ndonjë pengesë evidente, do t'ju bëhet e njohur. Nëse nga korrespondenca juaj me sekretarin del që ankesa juaj mund të regjistrohet si një kërkesë në Gjykatën e Strasburgut dhe nëse ju dëshironi që ajo të jetë e tillë, sekretari do t'ju dërgojë formularët që përdoren për të paraqitur formalisht kërkesën tuaj. Pasi t'i keni plotësuar dhe drejtuar ato sekretarit, kërkesa juaj do t'i paraqitet Gjykatës. Ju do të viheni në dijeni të ecurisë së procedurës nga sekretari. Kjo procedurë, të paktën në fillim, zhvillohet me shkrim. Kështu që, ju apo personi i autorizuar nga ju, nuk ka pse të paraqitet në selinë e Gjykatës. Nëse është e mundur, është më mirë që të ngarkoni një avokat të paraqesë kërkesën tuaj. Më vonë, gjatë procedurës, nëse duhet, ju mund të merrni ndihmë gjyqësore, në qoftë se nuk dispononi mjetet për të shpërblyer një avokat. Por kjo ndihmë nuk mund të jepet që në momentin e paraqitjes së kërkesës, por pasi ankesa të jetë pranuar për shqyrtim nga Gjykata e Strasburgut.

Konkluzioni

Pra, çdo veprim torture ose çdo dënim a trajtim tjetër mizor, ç'njerëzor ose degradues është një fyerje e dinjitetit njerëzor dhe duhet dënuar si një mohim i qëllimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe si një dhunim i të drejtave të njeriut dhe i lirive themelore të shpallura në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Ndonëse i ndaluar me të drejtën ndërkombëtare dhe i dënuar nga një numër i konventave ndërkombëtare, tortura vazhdon të jetë realitet predominant dhe mjaft i përhapur në kohën tonë. Tortura dhe keqtrajtimi vazhdojnë të praktikohen në shumë shtete, përfshirë shtetet nënshkruese të Konventës kundër Torturës. Presioni ndërkombëtar mund t'i detyrojë këto qeveri që të përdorin pushtetin e tyre për parandalimin e torturës, duke na dhënë një fije shpresë, se një ditë tortura do të jetë vetëm histori.

Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara tortura është prezente në shumë shtete, megjithë dënimin e saj nga komuniteti ndërkombëtar, ende është pjesë e sistemit të drejtësisë. Tortura është një krim, dhe ndalimi i saj është themelor dhe i padiskutueshëm rreth 50 shtete, përfshirë Iranin, Birmaninë dhe Vietnamin, nuk e kanë nënshkruar konventën ndërkombëtare të OKB-së kundër torturës të vitit 1987 andaj u bëhet thirrje këtyre shteteve të nënshkruajnë marrëveshjen dhe të hapin burgjet e tyre për kontroll nga ana e OKB-së. Organizata për të drejtat e njeriut, Amnesty International ka paralajmëruar se do tëbëhenpërpjekje nëmënyrë që të ndalohet tortura në këto shtete.

Tortura shkatërron meshkuj, gra e fëmijë, familje e komunitete. Tortura pamundëson zhvillimin njerëzor dhe ekonomik të shoqërisë, që është një ndër të drejtat e të gjithë njerëzve.

Ekzistojnë katastrofa që nuk mund të parandalohen, si tsunami. Megjithatë, tortura është një fatkeqësi e shkaktuar nga vetë njeriu. Ju mund të pengoni torturën dhe t'i shëroni viktimat e prekura nga ajo.

Literatura:

- Fjalori i gjuhës shqipe „Rilindja" Prishtinë 1976 f.569.
- Deklarata universale e të drejtave të njeriut e vitit 1948 .
- Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës.
- E drejta penale pjesa e posaçme Prof,Dr. Ismet Salihu.